

Raport Monitorimi i realizimit të zbatimit të Planit të Integritetit të bashkisë Lezhë për vitin 2022.

Hyrje

Integriteti institucional dhe lufta kundër korrupsionit konsiderohen si një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare. Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit në kryerjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative. Prioritizimi i kuadrit anti-korrupsion është jetësuar nëpërmjet forcimit të kompetencave dhe kapaciteteve të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, koordinimit dhe zbatimit të nismave anti-korrupsion të parashikara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015- 2023, si dhe të forcimit të kuadrit rregullator dhe të mekanizmave të menaxhimit të integritetit në administratën publike.

Ndërkohë, menaxhimi i riskut të integritetit për NJVV-të, si proces në vetvete rrjedh nga objektivi 11 i SNKK dhe masat përkatëse në Planin e Veprimit 2018-2020 rishikuar 2020-2023, si dhe objektivi D i SKNDQV, për zhvillimin dhe miratimin e politikave anti-korrupsion në nivel vendor.

Duke ju referuar nivelit vendor, nevoja për të forcuar në mënyrë të vazhdueshme sistemet e menaxhimit të integritetit në kuadër të thellimit të procesit të decentralizimit, është evidente. Procesi i decentralizimit (transferimi i pushteteve dhe përgjegjësisë nga qeverisja qendrore në atë vendore) i shërben forcimit të llogaridhënies duke e sjellë qeverinë më afër qytetarëve. Ndërkaq, i zbatuar në shërbimet publike, për shkak të rritjes së kontakteve midis zyrtarëve vendorë dhe qytetarëve, ky proces mund të decentralizojë edhe shfaqjen apo mundësinë e shfaqjes së risqeve të integritetit, duke penguar zvogëlimin apo eliminimin e plotë të tyre, gjë që bën të domosdoshme marrjen e masave menaxhuese proaktive ndaj këtyre risqeve.

Në këtë kontekst, hartimi i Planeve të Integritetit dhe Planeve përkatëse të Veprimit nga NJVV-të dhe monitorimi i realizimit të tyre ofrojnë kuadrin konceptual për politikën dhe masat për parandalimin e shkeljeve të integritetit të zyrtarëve publikë dhe për monitorimin e efekteve të masave të zbatuara në institucionet e qeverisjes vendore.

Menaxhimi i integritetit institucional dhe monitorimi si hallkë përbërëse e tij, synojnë të ndihmojnë politikëbërësit, administratat vendore dhe drejtuesit e shoqërisë civile për të përmirësuar kontrollin ndaj korrupsionit në shoqëritë dhe komunitetet e tyre. Ky proces u mundëson përdoruesve të shohin potencialin për përmirësim në fusha specifike të politikave dhe veprimtarisë së njësive vendore. Një analizë rigoroze e këtyre fushave ndihmon në zhvillimin e strategjive të bazuara në evidenca dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe masave konkrete për të parandaluar ose zvogëluar korrupsionin, duke garantuar qeverisje të mirë dhe efikase.

Rreth procesit dhe metodologjisë për monitorimin e Planit të Integritetit në nivel bashkie.

Miratimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore përbën një domosdoshmëri dhe është një objektivi specifik (objektivi A11) i Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe i Planit të saj të Veprimit, në të cilin parashikohet promovimi i planeve vendore të integritetit në nivel bashkiak, si një mundësi që qytetarët të njohin përpjekjet anti-korrupsion dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive për to. Plani i Veprimit (2018-2023), i miratuar në maj të vitit 2018, në kuadër të këtyre objektivave parashikon si masë hartimin dhe miratimin e planit të integritetit për çdo institucion publik në vend. Kjo vjen në linjë edhe me rekomandimet e Komisionit Evropian (2018) për Shqipërinë në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian, ku një nga rekomandimet e dhëna është zbatimi i dokumentit të Strategjisë Kundër Korrupsionit, duke iu referuar konkretisht mungesës së një sistemi funksional të menaxhimit të integritetit në institucionet publike në vend.

Gjithashtu menaxhimi i riskut të integritetit për NJVV-të, si proces mbështetet edhe nga objektivat e parashikuara në SKNDQV (objektivi D), për zhvillimin dhe miratimin e politikave anti-korrupsion në nivel vendor. Ai është një mekanizëm parandalues anti-korrupsion dhe instrument për futjen e mirëqeverisjes dhe mirë-menaxhimit në veprimtarinë e NJVV, duke i shërbyer nevojave dhe interesave të komunitetit vendor. Në qendër të procesit të menaxhimit të riskut të integritetit është Plani i Integritetit si instrument i luftës kundër korrupsionit në nivel vendor. Ai ofron kuadrin konceptual për politikën dhe masat për parandalimin e shkeljeve të integritetit të zyrtarëve publikë dhe për monitorimin e efekteve të masave të zbatuara në një institucion publik.

Procesi i menaxhimit të riskut të integritetit ka një qasje gjithëpërfshirëse ku angazhohen të gjitha strukturat e brendshme të bashkisë. Ndërsa hapi i parë i tij lidhet me hartimin e Planit të Integritetit për njësinë vendore (detajuar ky i fundit edhe me një plan veprimi 3-vjeçar), monitorimi dhe raportimi i Planit të Integritetit është etapa tjetër e menaxhimit të riskut në bashki. Monitorimi është periodik (çdo vit) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve dhe drejtuesve të bashkisë, për zbatimin e masave të miratuara për trajtimin e risqeve, në përputhje me përgjegjësitë që ata kanë. Ndërkaq raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e planit të veprimit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara.

Raporti i monitorimit është hartuar në përputhje me metodologjinë e monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore. Analiza e të dhënave dhe vlerësimi i progresit të zbatimit të Planit të veprimit të Planit të Integritetit për këtë periudhë raportimi është bërë në zbatim të Urdhrit nr. 553, datë 30.09.2021 “*Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore*”.

Raporti i monitorimit të Planit të Integritetit për NJVV-të të cilat e kanë miratuar gjatë vitit 2022, përmban një analizë të përgjithshme të realizimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në bazë të objektivave, aktorëve dhe afateve të përcaktuara në Planin e Integritetit (PI) dhe të Planit të Veprimit në kuadër të forcimit të integritetit dhe luftës kundër korrupsionit. Në raport identifikohet progresi i bërë, bazuar në situatën e arritjeve të treguesve, si dhe në zbatimin e masave konkrete dhe afatit të miratimit të PI.

Ky raport monitorimi mbulon periudhën prill-dhjetor 2022 për bashkinë Lezhë dhe është hartuar mbi bazën e inputit të dhënë nga strukturat e bashkisë për procesin monitorues në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit të Planit të Integritetit 2022-2025. Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit të Planit të Integritetit 2022-2025 të bashkisë për vitin 2022 është i pari raport i hartuar që prej miratimit të këtij dokumenti.

Monitorimi është bazuar në të dhënat që kanë raportuar strukturat përgjegjëse të integritetit në bashki referuar në Planin e Veprimit. Mbledhja e informacionit nga strukturat e mësipërme është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti monitorimi referuar nivelit të zbatimit të çdo objektivit sipas fushave me risk, masave (në bazë të aktiviteteve të kryera), hapave të ndërmarra, dokumentave të hartuara apo të publikuara, problematikave të hasura, rekomandimeve etj.

Plani i Integritetit do të vijojë të monitorohet në formë të planifikuar, periodikisht dhe përditësohet në përputhje me zhvillimet apo ndryshimet ligjore dhe nënligjore, institucionale, procedurale dhe të personelit që prekin funksionet dhe veprimtarinë e bashkisë. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Planit të Integritetit si një etapë e rëndësishme e ciklit të menaxhimit të risqeve të integritetit në bashki siguron që:

- aktivitetet e kontrollit dhe masat e trajtimit të risqeve të integritetit të jenë efektive në hartim dhe funksionim;
- procedurat të jenë të qarta;
- plani i integritetit dhe raporti i monitorimit të tij të publikohet në faqen zyrtare të bashkisë.

Raportimi është një procedurë e rregullt që do të sigurojë zbatimin e Planit të Veprimit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara.

Raporti i Monitorimit të PI për bashkinë Lezhë.

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të NJVV për vitin 2022, është i pari dokument i hartuar në përputhje me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.333, datë 07.10.2020.

Në Planin e Integritetit të bashkisë së monitoruar janë përcaktuar gjithsej 3 objektiva për të cilat janë parashikuar fushat me risk dhe masat dhe aktivitete për realizimin e tyre, pavarësisht konceptimit në veçanti, si vijon:

- **Objektivi I** “Përmirësimi i kuadrit të brendshëm politik dhe rregullator në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, si dhe parimeve të etikës dhe standardet e sjelljes profesionale”;
- **Objektivi II** “Konsolidimi i burimeve njerëzore, strukturave anti-korrupsion dhe pozicioneve të punës në bashki, të lidhura me funksionimin e mekanizmave të integritetit në institucion”;
- **Objektivi III** “Përmirësimi i menaxhimit të riskut të integritetit për fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë”.

Për bashkinë Lezhë, Plani i Integritetit është konceptuar i shtrirë në një periudhë 3-vjeçare dhe konkretisht 2022-2024.


Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet numri i objektivave, fushave me risk dhe masave/aktiviteteve sipas Planit të Veprimit të Planit të Integritetit 2022-2024, për bashkinë Lezhë.

Bashkia Lezhë	FUSHA ME RISK	MASA DHE AKTIVITETE
OBJEKTIVAT		
Objektivi 1	15	34
Objektivi 2	10	23
Objektivi 3	9	17
Totali	34	74

Situata e zbatimit të Planit të Integritetit bashkia Lezhë për periudhën prill–dhjetor 2022
rezulton si më poshtë:

Nga monitorimi i procesit në bashkinë Lezhë rezulton se në totalin prej **65** masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2022, janë **zbatuar 64** masa/aktivitete, **në proces zbatimi** ka mbetur **1** masë/aktivitet dhe **të pazbatuara 0** masa/aktivitete.

Situata e zbatimit në % të Planit të Integritetit per vitin
2022 bashkia Lezhë sipas PV (prill-dhjetor 2022)



Nga monitorimi rezulton se **98.5%** e masave/aktiviteteve janë **zbatuar** plotësisht, **në proces zbatimi** kanë mbetur **1.5%** masa/aktivitete dhe **të pazbatuara 0%** masa/aktivitete.

MONITORIMI SIPAS OBJEKTIVAVE NË NIVEL BASHKIE

Gjatë këtij viti në bashkinë Lezhë është bërë progres në përmirësimin e kuadrit të plotë rregullator në lidhje me etikën dhe integritetin, në fushën e burimeve njerëzore si dhe fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

MBLEDHJA DHE ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatorin e Integritetit të bashkisë Lezhë në përmbushje të rolit të tij si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen dhe analizën e informacionit mbi ecurinë e raportit të monitorimit.

Gjetjet të raportit:


Objektivi I “Përmirësimi i kuadrit të brendshëm politik dhe rregullator në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, si dhe parimeve të etikës dhe standardet e sjelljes profesionale”;

Përmes këtij objektivi synohet funksionimi i një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në institucion, gjë që kërkon përkushtimin e kreut të institucionit për të nxitur kulturën e integritetit institucional. Ky vullnet shprehet përmes miratimit të një kornize politike dhe rregullatore të bashkisë, e cila promovon dhe garanton integritetin si parim i mirëqeverisjes, interesin publik, transparencën dhe llogaridhënien institucionale. Ky objektivi përmban 34 masa/aktivitete specifike të planifikuara për tu zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit. Njësitë raportuese për këtë objektivi janë strukturat teknike të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Mjedisit, Drejtorinë Juridike, si dhe Grupet përkatëse të punës për rishikimin e Rregullores së Brendshme të bashkisë, për hartimin e PSV-së për dhënien e hapësirës publike për parking dhe transport, për rishikimin e rregullores së KB-së, për hartimin e PSV-ve për çdo njësi të bashkisë, si dhe për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut Financiar.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat, produktet dhe kryer aktivitetet sipas tabelës, si më poshtë:

Objektivi I	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të përealizuara
Përmirësimi i kuadrit të brendshëm politik dhe rregullator në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, si dhe parimeve të etikës dhe standardet e sjelljes profesionale.		34	33	1	0

Situata e zbatimit në % të Planit të Integritetit per vitin
2022 bashkia Lezhë Objektiv I (prill-dhjetor 2022)



Për këtë periudhë raportuese bashkia Lezhë ka performuar në zbatim të masave dhe aktiviteteve si vijon:

- Ngritja e një grupi pune për rishikimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të bashkisë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për aspekte të veçanta të funksionimit dhe mbarëvajtjes së bashkisë, si edhe me strukturën funksionale të bashkisë, publikimi i rregullores së miratuar dhe informimi i personelit të bashkisë mbi këtë rregullore;
- Publikimi i Urdhrit të Kryetarit të bashkisë për ngritjen dhe funksionimin e njësisë së prokurimit në bashkinë Lezhë, si dhe informimi i stafit të bashkisë për funksionimin e kësaj njësie në bashki;
- Parashikimi i qartë në rregulloren e bashkisë, i rregullave për zhdëmtimin, keqpërdorimin e aktiveve të bashkisë (referuar standardeve të kontabilizimit e të aseteve), si dhe detyrimet e punonjësve dhe palëve të treta, në rastin e ndodhjes së humbjes së vlerës përdoruese të asetit, informimi i personelit të bashkisë mbi këto rregulla, vlerësimi i nevojës së burimeve njerëzore të dedikuara për procesin e ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjen jashtë të përdorimit të aktiveve;
- Hartimi, miratimi dhe publikimi i politikës së institucionit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe reflektimi i zbatimit të politikës për mbrojtjen e të dhënave personale në manualin e vendeve të punës së punonjësve që do të merren me administrimin e dosjeve të personelit;
- Hartimi dhe miratimi i PSV-ve për shërbimet publike që ofron bashkia për dhënien e hapësirës publike për shërbimin parking dhe transport, si dhe informimi i stafit të bashkisë për përmbajtjen e tyre;

- Hartimi dhe miratimi i PSV-ve për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve për problematika që lidhen me fushën e shërbimeve publike, si dhe informimi i stafit të bashkisë për përmbajtjen e tyre;
- Parashikimi në rregulloren e KB-së për mundësinë e realizimit të mbledhjeve online në raste emergjencash, si ai i shkaktuar nga pandemia e COVID-19;
- Rishikim i rregullores për të përfshirë linjat dhe mënyrën e komunikimit ndërmjet drejtorive të ndryshme të bashkisë me institucionet e varësisë në bashki dhe institucionet e tjera, qofshin këto nëpërmjet postës elektronike apo dokument hardcopy, komunikim periodik për korrespondencën elektronike brenda bashkisë dhe me institucionet e tjera, nëpërmjet postës elektronike zyrtare, si dhe përcaktimi i këtij detyrimi në PSV-në përkatëse për procedurat e komunikimit në bashki dhe me institucione të tjera;
- Rishikimi i Rregullores së Brendshme për të përfshirë rregulla për mbrojtjen e të dhënave personale, referuar ligjit në fuqi, si dhe trajnime të personelit të bashkisë dhe anëtarëve të KB-së për rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Parashikimi i qartë në Rregulloren e Brendshme të rregullave për veprimtaritë e jashtme të punonjësve të bashkisë/ se përfshirja në Kodin e Sjelljes së Bashkisë, si dhe informimi i stafit mbi këto rregulla;
- Miratimi i rregullave për rolet dhe detyrat e kabinetit të kryetarit të bashkisë (rolet dhe përgjegjësitë e drejtuesit të këtij kabineti dhe zyrave përbërëse dhe këshilltarëve), përfshirja e rregullave për kabinetin e kryetarit për aspekte të etikës dhe integritetit në bashki, përfshirja e këtyre rregullave në rregulloren e brendshme të bashkisë, si dhe informimi mbi këto rregulla i kabinetit dhe stafit të bashkisë.

Masa/aktivitete ende në proces zbatimi:

- Hartimi, miratimi dhe publikimi i dokumentit të strategjisë së menaxhimit të riskut në përgjithësi dhe atij financiar në veçanti.

Masa/aktivitete të përealizuara nuk ka lidhur me këtë objektiv.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.


Objektivi II “Konsolidimi i burimeve njerëzore, strukturave anti-korrupsion dhe pozicioneve të punës në bashki, të lidhura me funksionimin e mekanizmave të integritetit në institucion”;

Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit në nivelin e proceseve të punës, sipas fushave funksionale të bashkisë, si dhe të forcojë kapacitetet teknike në nënprocese të ndryshme të punës, duke kontribuar në përmirësimin e standardeve profesionale dhe rezistencë më të lartë ndaj risqeve të integritetit. Ky objektivi përmban 23 masa/aktivitete specifike të planifikuara për tu zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit. Njësitë raportuese për këtë objektivi janë strukturat teknike të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Të Ardhurave Vendore, Sektori i Auditit të Brendshëm, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Grupet përkatëse të punës për rishikimin e Rregullores së Brendshme të bashkisë, si dhe për vlerësimin e nevojës për një strukturë të dedikuar të menaxhimit të pronave.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat, produktet dhe kryer aktivitetet sipas tabelës, si më poshtë:

Objektivi II	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të përealizuara
Konsolidimi i burimeve njerëzore, strukturave anti-korrupsion dhe pozicioneve të punës në bashki, të lidhura me funksionimin e mekanizmave të integritetit në institucion.		23	23	0	0

Situata e zbatimit në % të Planit të Integritetit per vitin
2022 bashkia Lezhë Objektivi II (prill-dhjetor 2022)



Nga realizimi i masave dhe aktiviteteve janë arritur rezultatet si më poshtë:

- Kryerja e një analize për vlerësimin e nevojave për vende pune shtesë në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, si dhe Analiza dhe gjetjet e saj të komunikuara titullarit të institucionit;
- Vlerësimi i nevojave për vende pune shtesë në njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe shpallja e vendeve të mundshme sipas kriterëve përkatëse (+4 auditues), vlerësimi i nevojës për funksionimin e strukturës së Auditit të Brendshëm si drejtori dhe jo si sektor (raporti i vlerësimit dhe rekomandimet e tij komunikuar Kryetarit të Bashkisë), realizimi i trajnimeve të dedikuara për stafin e njësisë së auditit mbi përditësimet ligjore në fushën e auditimit (p.sh auditimi i faturave fiskale), si dhe trajnime të dedikuara për procesin dhe legjislacionin e sinjalizimeve;
- Realizimi i trajnimeve të domosdoshme për stafin e AB për procesin e hetimit dhe shqyrtimit administrativ të sinjalizimeve për praktika apo veprime të dyshuara korrupsion, për stafin e AB- së, të ofruara nga ASPA apo ILDKPKI;
- Parashikimi në rregulloren e brendshme të bashkisë së funksionimit të njësisë së prokurimit vetëm me punonjës të bashkisë duke përjashtuar staf nga kabineti politik i kryetarit të bashkisë, si dhe informimi i kabinetit dhe stafit të bashkisë mbi këto rregulla;
- Ngritje e një grupi pune për vlerësimin e nevojës, për ngritjen e një strukture të dedikuar të unifikuar (një drejtori e posaçme), për menaxhimin e pronave në bashki, për t'iu përgjigjur nevojave të një bashkie të nivelit të mesëm, vlerësimi i përfshirjes nëpërmjet shtesës së një drejtorie në strukturën organizative të bashkisë e ngarkuar me përgjegjësinë për administrimin optimal të pronave të bashkisë, si dhe raporti i vlerësimit dhe rekomandimet e tij komunikuar Kryetarit të Bashkisë;

- Vlerësimi dhe pranimi nga DBNJ vetëm për kandidatët që plotësojnë kriteret e manualeve të vendeve të punës, si dhe rishikimi i kriterëve të punësimit për punonjësit e këtyre strukturave të pronave në bashki, me qëllim përfshirjen e topografëve, inxhinierëve dhe ekonomistëve;
- Rishikimi i rregullores së bashkisë në lidhje me funksionin dhe detyrat e Koordinatorit për të Drejtën për Informim dhe atij të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, si dhe përcaktimi qartë në rregullore për linjat e komunikimit ndërmjet drejtorive të bashkisë me koordinatorin për të drejtën për informim dhe atij të njoftimit dhe konsultimit publik;
- Shpallja e vakancës për pozicionin e specialistit të IT- së;
- Vlerësimi i nevojave për vende pune shtesë me qëllim përfshirjen e inxhinierëve dhe ekonomistëve, si dhe komunikimi i vlerësimit dhe gjetjeve tek titullari i institucionit;
- Plotësimi me personel të përhershëm me të gjitha drejtoritë;
- Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive për punonjësit që do të menaxhojnë dosjet e personelit në sistemin e qendëruar si dhe reflektimi i roleve dhe përgjegjësive në sistem nëpërmjet të drejtave "Read" dhe "Edit", si dhe krijimi i një plani pune me afate të vendosura për ndjekjen dhe minimizimin e vonesave të pajustificuara;
- Përfshirja në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, e detyrimit për kryerjen e analizës së nevojave për trajnim, si edhe vlerësimin e ndikimit të trajnimeve tek punonjësit, hartimi dhe miratimi i planit vjetor të trajnimeve për bashkinë (në vijim të realizimit të performancës vjetore, realizimi i planit vjetor i trajnimeve, i cili merr në konsideratë pikat e dobëta të paraqitura nga vlerësimi i punonjësve si dhe ato pika që duhen përmirësuar), si dhe kryerja e vlerësimit vjetor për trajnimet, vlerësimi i ndikimit të trajnimeve tek punonjësit, si dhe parashikimi i një zëri buxhetor në buxhetin e bashkisë për trajnimet e brendshme të bashkisë.

Masa/aktivitete ende në proces zbatimi nuk ka lidhur me këtë objektiv.

Masa/aktivitete të përealizuara nuk ka lidhur me këtë objektiv.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.


Objektivi III “Përmirësimi i menaxhimit të riskut të integritetit për fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë”.

Ky objektivi synon të përmirësojë efektivitetin, efikasitetin dhe cilësinë e proceseve të punës në fushat funksionale të bashkisë të tilla si menaxhimi financiar, shërbimeve publike, planifikimit të territorit, menaxhimit të pronave dhe asetëve publike, etj, duke i bërë më rezistente ndaj shkeljeve të mundshme të integritetit. Ky objektivi përmban 17 masa/aktivitete specifike të planifikuara për tu zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit. Njësitë raportuese për këtë objektivi janë Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Të Ardhurave Vendore, Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, Koordinatorin për të drejtën për Informim, Drejtorinë përkatëse të bashkisë që administrojnë kontratat publike, Sektorin e Auditit të Brendshëm, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Mjedisit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, si dhe Grupin përkatës të punës për rishikimin e Rregullores së Brendshme të bashkisë.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat, produktet dhe kryer aktivitetet sipas tabelës, si më poshtë:

Objektivi III	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të përfunduara
Përmirësimi i menaxhimit të riskut të integritetit për fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.		17	17	0	0

Situata e zbatimit në % të Planit të Integritetit per vitin
2022 bashkia Lezhë Objektiv III (prill-dhjetor 2022)



Për këtë periudhë raportimi nga realizimi i masave dhe aktiviteteve ka arritur të ketë rezultate pozitive në këto drejtime:

- Parashikimi në Rregulloren e Këshillit Bashkiak, i detyrimit për rakordimin e dokumenteve buxhetore të miratuara në KB me projekt-buxhetin e miratuar nga bashkia, si dhe hartimi dhe miratimi i rregullave në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë për:
 - rastet e ndryshimit të zërave buxhetorë (duke përfshirë dhe situata emergjente psh. rindërtimi post-tërmet apo pandemia, etj);
 - detyrimi për përgatitjen e një relacioni ku argumentohet kërkesa për ndryshim;
- Parashikimi në Rregulloren e Brendshme të bashkisë, i detyrimit për informim periodik për zbatimin e buxhetit pranë drejtorive të përgjithshme dhe titullarit të bashkisë dhe afateve përkatëse;
- Konsultimi me grupet e interesit mbi kostot dhe përfitimet e paketës fiskale, para miratimit të paketës fiskale, publikimi i paketës fiskale në faqen e internetit të bashkisë, informimi dhe aksesimi mbi paketën fiskale pranë zyrave të bashkisë, si dhe informimi i publikut (në faqen zyrtare të bashkisë) i masave ndëshkuese lidhur me mospagimin e detyrimeve (përfshirë edhe afatet);
- Publikim i informacionit për zbatimin dhe monitorimin e kontratave publike;
- Publikimi i raporteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm të bashkisë;
- Hartimi, miratimi dhe publikimi i instrumenteve monitoruese të performancës së shërbimit;
- Zhvillimi i aktiviteteve informuese për publikun në lidhje me përmbajtjen e planit vendor dhe përfitimet e pjesëmarrjes së dëgjësave publike, si dhe i trajnimeve për personelin e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit për procedurat e konsultimit publik.

Masa/aktivitete ende në proces zbatimi nuk ka lidhur me këtë objektiv.

Masa/aktivitete të përealizuara nuk ka lidhur me këtë objektiv.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

PËRMBLEDHJA E GJETJEVE

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit planit të integritetit dhe hartimit të raportit të monitorimit. Në mbyllje të këtij raporti për vitin 2022, të gjetjeve që ky dokument ofron, të të dhënave analitike raportuese, rezulton se:

Objektivi I

Në lidhje me zbatimin e masave/aktiviteteve **rreth përmirësimit të kuadrit të brendshëm politik dhe rregullator në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, si dhe parimeve të etikës dhe standardet e sjelljes profesionale janë realizuar plotësisht** ngritja e një grupi pune për rishikimin e RrBB në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për aspekte të veçanta të funksionimit dhe mbarëvajtjes së bashkisë, si edhe me strukturën funksionale të bashkisë, publikimi i rregullores së miratuar dhe informimi i personelit të bashkisë mbi këtë rregullore. Është publikuar Urdhri i Kryetarit të bashkisë për ngritjen dhe funksionimin e njësisë së prokurimit në bashkinë Lezhë, si dhe është informuar stafit të bashkisë mbi funksionimin e kësaj njësie në bashki. Janë përfshirë në RrBB rregullat për menaxhimin e aktiveve të bashkisë (zhdëmtimin, keqpërdorimin e aktiveve të bashkisë referuar standardeve të kontabilizimit e të asetëve), detyrimet e punonjësve dhe palëve të treta në rast të humbjes së vlerës përdoruese të asetit, informimi i personelit të bashkisë mbi këto rregulla, si dhe vlerësimi i nevojës së burimeve njerëzore të dedikuara për procesin e ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjen jashtë të përdorimit të aktiveve.

Është hartuar, miratuar dhe publikuar politika e institucionit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe reflektimi i zbatimit të saj në manualin e vendeve të punës së punonjësve që do të merren me administrimin e dosjeve të personelit. Janë hartuar dhe miratuar PSV-të mbi shërbimet publike që ofron bashkia për dhënien e hapësirës publike për shërbimin parking dhe transport, mbi shqyrtimin e ankesave të qytetarëve për problematika që lidhen me fushën e shërbimeve publike si dhe është informuar stafi i bashkisë për përmbajtjen e tyre. Gjithashtu është parashikuar në rregulloren e KB-së mundësia e realizimit të mbledhjeve online në raste emergjencash, si ato të shkaktuara nga pandemia e COVID-19. Është rishikuar rregullorja për të përfshirë linjat dhe mënyrën e komunikimit ndërmjet drejtorive të bashkisë me institucionet e varësisë në bashki dhe institucionet e tjera, qofshin këto nëpërmjet postës elektronike apo dokument hardcopy,

komunikimin periodik për korrespondencën elektronike brenda bashkisë dhe me institucionet e tjera, nëpërmjet postës elektronike zyrtare, si dhe përcaktimin e këtij detyrimi në PSV-në përkatëse për procedurat e komunikimit në bashki dhe me institucione të tjera. Është rishikuar RrBB për të përfshirë rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, referuar ligjit në fuqi, si dhe trajnime të personelit të bashkisë dhe anëtarëve të KB-së për rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale. Po kështu në RrBB janë parashikuar rregullat për veprimtaritë e jashtme të punonjësve të bashkisë, janë përfshirë në Kodin e Sjelljes së Bashkisë dhe është informuar stafi mbi këto rregulla. Gjithashtu janë miratuar rregullat për rolet dhe detyrat e kabinetit të kryetarit të bashkisë, janë përfshirë këto rregulla tek aspektet e etikës e integritetit në bashki dhe në rregulloren e brendshme të bashkisë, si dhe janë informuar mbi këto rregulla kabineti dhe stafi i bashkisë. Ndërkaq, mbetet **ende në proces zbatimi** hartimi, miratimi dhe publikimi i dokumentit të strategjisë së menaxhimit të riskut në përgjithësi dhe atij financiar në veçanti. **Nuk ka masa/aktivitete të perealizuara.**

Objektivi II

Përsa i përket zbatimit të masave/aktiviteteve rreth **konsolidimit të burimeve njerëzore, strukturave anti-korrupsion dhe pozicioneve të punës në bashki, të lidhura me funksionimin e mekanizmave të integritetit në institucion** janë realizuar plotësisht kryerja e një analize për vlerësimin e nevojave për vende pune shtesë në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, si dhe Analiza dhe gjetjet e saj të komunikuar titullarit të institucionit. Po kështu është kryer vlerësimi i nevojës për vende pune shtesë në njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe shpallja e vendeve të mundshme sipas kriterëve përkatëse (+4 auditues), vlerësimi i nevojës për funksionimin e strukturës së Auditit të Brendshëm (AB) si drejtori dhe jo si sektor (raporti i vlerësimit dhe rekomandimet e tij komunikuar Kryetarit të Bashkisë), trajnimet e dedikuara për stafin e njësisë së auditit mbi përditësimet ligjore në fushën e auditimit si dhe trajnime të dedikuara për procesin dhe legjislacionin e sinjalizimeve. Janë realizuar trajnimet e domosdoshme për stafin e AB për procesin e hetimit dhe shqyrtimit administrativ të sinjalizimeve për praktika apo veprime të dyshuara korrupsion, të ofruara nga ASPA dhe ILDKPKI. Në RrBB është kryer parashikimi i funksionimit të njësisë së prokurimit vetëm me punonjës të bashkisë duke përjashtuar staf nga kabineti politik i kryetarit të bashkisë, si dhe informimi i kabinetit dhe stafit të bashkisë mbi këto rregulla. Është ngritur një grup pune për vlerësimin e nevojës, për ngritjen e një drejtorie të posaçme, për menaxhimin e pronave në bashki, është kryer vlerësimi i kësaj nevoje si dhe raporti i vlerësimit dhe rekomandimet e tij i janë komunikuar Kryetarit të Bashkisë.

Gjithashtu është realizuar vlerësimi dhe pranimi nga DBNJ vetëm i kandidatëve që plotësojnë kriteret e manualeve të vendeve të punës, si dhe është bërë rishikimi i kriterëve të punësimit për punonjësit e strukturave të pronave në bashki, me qëllim përfshirjen e topografëve, inxhinierëve dhe ekonomistëve. Është rishikuar rregullorja e bashkisë në lidhje me funksionin dhe detyrat e Koordinatorit për të Drejtën për Informim dhe atij të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, si dhe janë përcaktuar qartë në rregulloren linjat e komunikimit midis drejtorive të bashkisë dhe koordinatorit për të drejtën për informim dhe atij të njoftimit dhe konsultimit publik. Është shpallur vakanca për pozicionin e specialistit të IT- së, janë vlerësuar nevojat për vende pune shtesë me qëllim përfshirjen e inxhinierëve dhe ekonomistëve, rezultatet e vlerësimit dhe gjetjeve i janë komunikuar titullarit të institucionit si edhe janë marrë masat për plotësimin me personel të përhershëm në të gjitha drejtoritë. Gjithashtu, janë përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë për punonjësit

që do të menaxhojnë dosjet e personelit në sistemin e qendëruar, është kryer reflektimi i roleve dhe përgjegjësiëve në sistem nëpërmjet të drejtave "Read" dhe "Edit", si dhe është hartuar plani i punës me afate të vendosura për ndjekjen dhe minimizimin e vonësive të pajustificuara. Në RrBB është përfshirë detyrimi për kryerjen e analizës së nevojave për trajnim, si edhe vlerësimin e ndikimit të trajnimeve tek punonjësit, hartimin dhe miratimin e planit vjetor të trajnimeve për bashkinë si dhe kryerjen e vlerësimit vjetor për trajnimet, vlerësimin e ndikimit të trajnimeve tek punonjësit, si dhe parashikimin e një zëri buxhetor në buxhetin e bashkisë për trajnimet e brendshme të bashkisë. Përsa i përket **masave/aktiviteteve ende në proces zbatimi dhe atyre të përealizuara, nuk ka të tilla .**

Objektivi III

Në lidhje me zbatimin e masave/aktiviteteve rreth **përmirësimit të menaxhimit të riskut të integritetit për fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë janë realizuar plotësisht** parashikimi në Rregulloren e Këshillit Bashkiak, i detyrimit për rakordimin e dokumenteve buxhetore të miratuara në KB me projekt-buxhetin e miratuar nga bashkia, si dhe hartimi dhe miratimi i rregullave në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë për rastet e ndryshimit të zërave buxhetorë si dhe detyrimin për përgatitjen e një relacioni ku argumentohet kërkesa për ndryshim. Është parashikuar në Rregulloren e Brendshme të bashkisë detyrimi për informim periodik për zbatimin e buxhetit pranë drejtorive të përgjithshme dhe titullarit të bashkisë dhe afateve përkatëse si edhe është kryer konsultimi me grupet e interesit mbi kostot dhe përfitimet e paketës fiskale para miratimit të paketës fiskale, publikimi i paketës fiskale në faqen e internetit të bashkisë, informimi dhe aksesimi mbi paketën fiskale pranë zyrave të bashkisë, si dhe informimi i publikut (në faqen zyrtare të bashkisë) rreth masave ndëshkuese lidhur me mospagimin e detyrimeve (përfshirë edhe afatet). Gjithashtu janë publikuar informacioni për zbatimin dhe monitorimin e kontratave publike, si dhe raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm të bashkisë. Janë hartuar, miratuar dhe publikuar instrumentet monitoruese të performancës së shërbimit, janë zhvilluar aktivitete informuese për publikun në lidhje me përmbajtjen e planit vendor dhe përfitimet e pjesëmarrjes në dëgjesat publike, si dhe janë organizuar trajnime për personelin e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit mbi procedurat e konsultimit publik. Përsa i përket **masave/aktiviteteve ende në proces zbatimi dhe atyre të përealizuara, nuk ka të tilla .**

Si përfundim:

Nga monitorimi rezulton se **98.5% e masave/aktiviteteve janë zbatuar plotësisht, në proces zbatimi kanë mbetur 1.5% masa/aktivitete dhe të pazbatuara 0% masa/aktivitete.**

Sipas objektivave rezulton se **bashkia ka performuar më mirë** në zbatim të masave/aktiviteteve të **objektivit të dytë dhe të tretë, me 100% te masave/aktiviteteve të realizuara** plotësisht.

Në **vendin e dytë** për nga zbatueshmëria renditet **objektivi i parë me 97% të masave/aktiviteteve të realizuara** plotësisht.

REKOMANDIME

Bashkia Lezhë ka vijuar punën për zbatimin e Planit të Integritetit. Ajo ka patur arritje shumë të mira në përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional, nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të kuadrit të nevojshëm rregullator për çështje të veçanta të integritetit, miratimit dhe përmirësimit të kuadrit të brendshëm institucional dhe aftësimin të burimeve njerëzore e ngritjes së kapaciteteve për menaxhimin e tij. Edhe në kuadër të këtyre arritjeve ka përsëri vlerë të rekomandohet që:

- ✓ Të vijohet me zbatimin dhe raportimin e masave dhe angazhimeve të evidentuara më sipër që vijojnë të jenë në proces apo janë të përcaktuara, sipas fushave të etikës, burimeve njerëzore dhe fushave të veçanta të përgjegjësisë;
- ✓ Dërgimi brenda afateve të përcaktuara si dhe në përputhje me formatet e kërkuara të kontributeve nga strukturat dhe institucionet përgjegjëse;
- ✓ Përmirësimi i kapaciteteve në strukturat/institucionet përkatëse për zbatimin dhe raportimin sipas metodologjisë së monitorimit të PI.